**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER SOFIKA K. BRAKA**
**ADRESA NR.5, ISMAIL QEMALI, NR.11, NR.1, NR.1**
**TEL: 684066835**

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 1178** **Nr. koleksioni: 736**

**Tirane më 08/10/2021**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2021052850074492961

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**Nr.** 1178 **Rep. Nr.** 736 **Kol.**

**KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH**

Sot me datën 08.10.2021 përpara meje Notere Sofika K. BRAKA, anëtare e Dhomës se Noterëve Tiranë, me seli ne Rr."Ismail Qemali" Pall. 11/1, Apartamenti 1, Tirane, u paraqitën personalisht personat e mëposhtëm për lidhjen e kësaj kontrate shitblerje kuotash te kapitalit te shoqërisë:

**Shitësi:**

- **z. Gentian Priftaj**, atësia: Andon, lindur me 19.12.1975 ne Përmet dhe banues ne Tirane, ne adresën Rruga "Vaçe Zela", identifikuar me Letërnjoftimin ID nr. 034119251 dhe me numër personal H51219115J, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e personit të besuar dhe zotëruesit aktiv të kuotave të shoqërisë "INTER.TEK WESTERN BALKANS" Sh.p.k.,

**Blerësi:**

- **z. Aurel Stavre**, i biri i Mihallaqit, i datëlindjes 09.07.1986, lindur në Durrës e banues në Tiranë, madhor me zotësi te plotë për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftimin ID nr. 034301374 dhe me numër personal I60709063I, madhor me zotësi te plote juridike për te vepruar.

**Neni 1**

1.1 Shitësi është personi i besuar dhe zotëruesi aktiv i 100% të kuotave të shoqërisë "INTER.TEK WESTERN BALKANS" Sh.p.k., regjistruar si person juridik në datën 24.01.2018, me NUIS: L81324046T, me seli në Tiranë, rruga "Vaso Pasha", pallati 13/1, kati 3/D.

1.2 Këto kuota të kapitalit të shoqërisë "INTER.TEK WESTERN BALKANS" Sh.p.k., që ai zotëron, ia shet me vlerën e tyre nominale Blerësit **Aurel Stavre** në masën 100%, i cili pranon t'i blejë ato, sipas kushteve te përcaktuara me poshtë në këtë kontratë.

**Neni 2**

2.1 Çmimi i shitjes së 100% të kuotave të shoqërisë "INTER.TEK WESTERN BALKANS" Sh.p.k., është me vlerën e tyre nominale prej 2.100.000 *(dy milionë e njëqind mijë)* Lekë.

2.2 Ky çmim do të likuidohet nga blerësi në llogarinë bankare të shitësit dhe do të vërtetohet me mandatin bankar përkatës.

**Neni 3**

3.1 Blerësi i blen kuotat që shet shitësi ne raportin e mëposhtëm:
**z. Aurel Stavre,** blen dhe behet ortak me 100% (njëqind përqind) të kuotave, të shoqërisë "INTER.TEK WESTERN BALKANS" Sh.p.k., me vlerë 2.100.000 *(dy milionë e njëqind mijë)* Lekë.

3.2 Me shitjen e këtyre kuotave, qe shitësi i shet blerësit nga ato te zotëruara prej tij, blerësi bëhet pronar i këtyre kuotave me te drejta te plota në raportet e mëposhtme:

**z. Aurel Stavre** - zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 2.100.000 *(dy milionë e njëqind mijë)* Lekë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar.

**Neni 4**

4.1 Shitësi deklaron se është pronar me të drejta të plota mbi kuotat që i transferon blerësit; nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e tyre apo që t'u ketë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi to deri në datën e sotme; ia shet këto kuota të kapitalit të shoqërisë, Blerësit, të lira nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë, të drejtat mbi to, nuk janë të përfshira në procese civile, penale, administrative, arbitrazhi apo të çfarëdo lloj natyre tjetër që të mund të jetë shkak për cënimin e kontratës apo titullin e pronësisë së blerësit mbi to.

**Neni 5**

5.1 Palët deklarojnë se do te zbatojnë rigorozisht te gjitha te drejtat e detyrimet e tyre qe rrjedhin nga kjo kontrate.

5.2 Ne rast mosmarrëveshje midis tyre ne zbatim te kësaj kontrate, palët do te bëjnë te gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Ne rast se nuk do te arrijnë ne

zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Unë Noterja mora autorizimin për përdorimin e te dhënave personale të palëve dhe të dhënat e përdorura në këtë dokument, të cilat do të jenë konfidenciale dhe vetëm për qëllimin dhe redaktimin e këtij akti. Përpunimi i të dhënave në akt do të bëhet në respektim të plotë dhe rigoroz të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar, *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*

Kontrata hartohet në 4 (katër) ekzemplarë, me të njëjtën vlerë ligjore. Unë noterja, pasi iu bëra me dijeni palëve, të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi për këtë kontratë që realizojnë, u lexova palëve Kontratën me zë të lartë e të qartë. Kontrata u lexua prej vetë atyre dhe, palët pasi deklarojnë se e gjejnë atë të rregullt e në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, e nënshkruajnë në praninë time.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018, date 20.12.2018, "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

**PALET KONTRAKTORE**

**SHITËSI**
**Gentian PRIFTAJ**

**BLERËSI**
**Aurel STAVRE**

**N O T E R E**
**Sofika K. BRAKA**

Taksa e Paguar u Pagua